



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË,  
ZHVILLIMIT RURAL DHE  
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr . .....Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2016

*Lënda: Njoftim për fillimin e procesit të konsultimit publik për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, date 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar*

Drejtuar: **BASHKISË**

**KËSHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR**

**TIRANË**

<b>DEPOS FARMACEUTIKE</b>	<b>ANIPHARM SH.P.K</b>
<b>DEPOS FARMACEUTIKE</b>	<b>FARMVETLEZHA SH.P.K</b>
<b>DEPOS FARMACEUTIKE</b>	<b>IMIFARMA SH.P.K</b>
<b>DEPOS FARMACEUTIKE</b>	<b>MILIFAR SH.P.K</b>
<b>DEPOS FARMACEUTIKE</b>	<b>ODIMPEX SH.P.K</b>
<b>DEPOS FARMACEUTIKE</b>	<b>PEGASUS VET SH.P.K</b>
<b>DEPOS FARMACEUTIKE</b>	<b>REAFARM SH.P.K</b>
<b>DEPOS FARMACEUTIKE</b>	<b>SHEDULA SH.P.K</b>
<b>DEPOS FARMACEUTIKE</b>	<b>SM FARM SH.P.K</b>
<b>DEPOS FARMACEUTIKE</b>	<b>VETAL SH.P.K</b>

**TIRANË**

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), ka iniciuar përgatitjen e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, do të organizojë konsultimin publik me Organet Publike (Bashkitë) dhe Grupet e Interesit (Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar dhe Depot farmaceutike).

Arsyeja kryesore të nevojshme për hartimin e këtij projektligji për disa ndryshime në ligjin aktual është boshllëku ligjor i krijuar me miratimin e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" ku njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë më kompetenca të përcaktuara që të kenë në strukturat e tyre shërbim veterinar, ndaj ndryshimet në ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, janë të domosdoshme në kuadër edhe të Reformës së shërbimit veterinar dhe rekomandimeve të OIE dhe BE për të unifikuar shërbimin veterinar në Shqipëri. Në këtë mënyrë këto ndryshime do të lejojnë kalimin e kompetencave dhe funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit lokal në strukturën e shërbimit veterinar në MBZHRAU.

Gjithashtu gjatë zbatimit të detyrave të përdishme, shërbimi veterinar ka hasur vakume ligjore të ndryshme dhe nëpërmjet kësaj ndryshimeve synohet të përmirësohet kuadri ligjor për të mbështetur në ngritjen e standardeve me lidhje me shëndetin e kafshëve dhe regjistrimin e Produkteve Mjekësore Veterinare.

Miratimi i këtij Projektligji do të ndikojë edhe në përmirësimin e ligjit aktual në përputhje me standardet e vendosura në Ligjin e Shëndetit të Kafshëve të BE-së.

Qëllimi i projektligji:

- Qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, rregjistrimin e Produkteve Mjekësore.

Ndikimet që do të ketë ky projektligj janë:

- Fermat do të zbatohen e biosigurinë me qëllim reduktimin e rrezikut të hyrjes, zhvillimit ose përhapjes të sëmundjeve tek kafshët në fermë dhe/ose objekt, zonat ose çdo ambienti tjetër dhe mjetet e transportit".
- Fusha e veprimtarisë së veterinerit zyrtar do të përfshijë edhe kontrollin shëndetësor të kafshës para dhe pas therjes, tregjet e kafshëve të gjalla, kullota dhe njësitë e shitjes së kafshëve të shoqërimit dhe zbukurimit.
- Komisioni Shtetëror i PMV-ve do të pranojë dhe miratojë vetëm PMV-të e shoqëruara me certifikatën e tregtimit të lëshuar nga Agjencia Evropiane e Medikamenteve (EMA) ose në një nga vendet e BE-së.

Afati:

- Afati i procesit të konsultimit është deri më datën 20.01.2017, periudhë gjatë së cilës ju mund të konsultoni projektligjin dhe relacionin përkatës dhe mbi këtë bazë mund të dërgoni rekomandimet dhe komentet tuaja tek Drejtori i Drejtorisë Veterinare në MBZHRAU, në rrugë elektronike në adresën: [Edi.Ferro@bujqesia.gov.al](mailto:Edi.Ferro@bujqesia.gov.al).

Organizimi i takimit:

- Në datën 23.01.2017, ora 11.00 në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave do të zhvillohet takimi publik përmyllës, ku jeni të lutur të merrni pjesë.

Dokumentacioni:

- Projektligjin e gjeni të publikuar në faqen elektronike të MBZHRAU në adresën: [www.bujqesia.gov.al/](http://www.bujqesia.gov.al/).

*Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.*

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**VOJO BREGU**